



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK. Nr. 236/2020  
Datë: 26 tetor 2020

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 18 të Ligjit Nr. 05/L-129, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenit 4, 7 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Panelit për Lirim me Kusht (KGJK, nr. 39), në mbledhjen e 240-të, të mbajtur me datë 26 tetor 2020, nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. Anëtarë për të shërbyer në Panelin për Lirim me Kusht, nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, emërohen si në vijim:
  1. Rasim Rasimi, gjyqtar, Gjykata Supreme e Kosovës, kryesues i PLK-së,
  2. Beshir Islami, gjyqtar, Gjykata Supreme e Kosovës, anëtar rezervë i PLK-së.
- II. Mandati i anëtarëve të panelit është dy (2) vite.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 26 tetor 2020.

### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka pranuar nga kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës vendimin për delegimin e gjyqtarëve nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, për anëtar të Panelit për Lirim me Kusht. Bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 05/L-129, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, kryetari i Gjykatës Supreme delegon z. Rasim Rasimi, gjyqtar në Gjykatën Supreme të Kosovës për anëtar të Panelit për Lirim me Kusht, përkatësisht, kryesues të këtij paneli, si dhe z. Beshir Islami, gjyqtar në Gjykatën Supreme, anëtar rezervë të panelit.

KGJK, në takimin e datës 26 tetor 2020, pas shqyrtimit të vendimit për delegim të gjyqtarëve nga radhët e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, për vazhdimin e mandatit të z. Rasim Rasimi edhe për një mandat shtesë, si dhe emërimin si anëtar rezervë të z. Beshir Islami.

Skender SOÇAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të Panelit për Lirim me Kusht;
- Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës;
- UD Koordinatorit të Panelit për Lirim me Kusht;
- Sekretariatit të KGJK-së;
- Arkivit.